



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Nr. 5-1910
Dt. 21.09.2022

Komisioni për licencimin e BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 5/1910 të datës 28.07.2022, të parashtruar nga BPrAL- Kolegji “RIT Kosovo (A.U.K) College, dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - Kolegji ” RIT Kosovo (A.U. K) College “ me seli në Prishtinë.
2. Licenca zgjatë nga 1 tetori 2022 e deri me 30 shtator 2025, për aq kohë sa institucioni ka akreditim sipas vendimit ref. 475/22 i datës 15.04.2022 nga Agjencioni për Akreditim i Kosovës.
3. Licenca për programin : Informatikë dhe Teknologji Informative BSc zgjatë nga 1 tetori 2020 deri me 31 shtator 2023 sipas vendimit nr. 1035/22 i datës 02.08.2022 i Agjencionit të Kosovës për Akreditim .
4. Licenca për programin: Studime Profesional, MSc 66 ECTS me specializim Parashikim Startegjik dhe Inovacion zgjatë nga 1 tetori 2022 deri me 30 shtator 2025, sipas vendimit nr. 1323/22 i datës 16.09.2022 oi Agjencionit të Kosovës për Akreditim.
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për Licencim të BPrAL, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 5/1910 i datës 28.07.2022 të parashtruar nga Kolegji “ RIT Kosovo (A.U.K) College ”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret sipas Ligjit të Arsimit të Lartë (Ligji Nr. 04/L-037 i datës 29 gusht 2011) dhe aktit nënligjor (U.A nr. 25/2012) për Licencimin e BPrAL.

Licenca e këtij Institucioni Privat të Arsimit të Lartë zgjatë tri vite akademike nga: 1 tetor 2022 deri me 30 shtator 2025 i mbështetur në vendimin e AKA i cekur në pikën 2.

Ndërkaq Programet e licencuara zgjasin sipas vendimeve të AKA-së të paraqitura në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi.

Komisioni për Licencim i MASHTI, duke marrë parasysh faktografinë dokumentuese materiale të këtij institucioni të parashtruara si aplikim për Licencim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi te Sekretari i Përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.



Kryetar i Komisionit

Burim Gashi